

Në bazë të nenit 21 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 23.08.2013, nenit 18 të Ligjit për Ndërtim Nr.04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 21 dhe 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-03 dt.21.06.2016, nenit 17, pika “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, dhe në bazë të kërkesës 05 nr. 350/02-112159/19 dt.16.05.2019 të pronarit Florim Murtezi nga Hajvali-Prishtinë, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektit ideor, për ndërtimin e shtëpisë individuale të banimit në Hajvali, në kuadër Planit Zhvillimor Komunal-PZHK-së, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datë 03.07.2019, merr këtë:

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE

I. I Caktohen kushtet ndërtimore pronarit Florim Murtezi nga fsh.Hajvali, sipas kërkesës 05 nr. 350/02-112159/19 dt.16.05.2019, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit ideor për ndërtimin e shtëpisë individuale të banimit, në kuadër të Planit Zhvillimor Komunal PZHK-së në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 608-25 ZK Hajvali.

II. Lokacioni i parcelës kadastrale të lartcekur, për të cilin caktohen kushtet ndërtimore, sipas dokumenteve të planifikimit hapësinor, përfshihet në kuadër të:

Planit Zhvillimor Komunal, miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 031-156871 dt. 27.08.2013, dhe kjo zonë është e planifikuar me destinim “Zonë ekzistuese urbane”;

Pronari me "Informim nga Plani Zhvillimor Komunal -PZHK-së, me referencë nr.2225 dt.13.05.2019, lëshuar nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillim të Qëndrueshëm të Komunës së Prishtinës, është informuar me kriteret, parametrat urban dhe kushtet e ndërtimit.

III. Gjendja ekzistuese e lokacionit - parcelës kadastrale të trajtuar, sipas gjendjes kadastrale, faktike dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor, është:

- Numri, sipërfaqja, pronari dhe klasa e kualitetit të parcelës kadastrale, është:
 - nr. 608-25, me S=588m², me pronar Florim Murtezi, “Tokë ndërtimore”;
- E drejta pronësore-juridike është private, në bazë të kopjes së planit dhe certifikatës së njësisë kadastrale;
- Në kuadër të parcelës kadastrale nr.608-25 ZK Hajvali, ka një ndërtesë të ndërtuar, e cila është propozuar të rrënohet, si dhe ka filluar ndërtimi i ndërtesës së planifikuar për ndërtim sipas propozimit për Kushte Ndërtimore;
- Është tokë urbane, me infrastrukturë: rrugë, ujë, kanalizim, elektrikë, etj.;
- Terreni i parcelës është kryesisht i rrafshët ;
- Qasja ekzistuese e parcelës kadastrale është përmes parcelës kadastrale nr.608-23 pronari ka siguruar pëlqimin për qasje, gjegjësisht rrugës ekzistuese;
- Parcela kadastrale e lartcekur shtrihet në kuadër të Planit Zhvillimor Komunal;
- Në kuadër të perimetrit prej 50m’ të parcelës kadastrale në fjalë, përfshihen ndërtesa individuale banimore.



Komunal -PZHK-së në Prishtinë, bazuar në parametrat urban të planit, janë:

- Organizimi me qasje në kuadër të parcelës kadastrale, pozicionimi, gabariti dhe etazhitei i ndërtesës, në raport me vijën rregulluese dhe atë ndërtimore, distanca e ndërtesës nga kufiri i parcelave, si dhe kushtet tjera për rregullimin e hapësirës, të jenë në tërësi sipas prezantimit grafik bashkëngjitur këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore;
- Destinimi i shfrytëzimit të ndërtesës, sipas planit rregullues, me hapësira përcjellëse, si: kthina teknike, depo, hapësira të garazheve, etj. (*sipas projektit konceptual të prezantuar*);
- Etazhitei maksimal i lejuar, sipas Planit Zhvillimor Komunal-PZHK-së, është P+1, poashtu i propozuar dhe i miratuar është B+P+1
- Koeficienti i shfrytëzimit maksimal të parcelës ndërtimore- brenda vijës rregulluese (ISHP), për vendosjen e ndërtesës në bazë-gabarit të përdhësës ose suterren, është max.30%;
- Bazuar në kriteret e Planit Zhvillimor Komunal /PZHK-së, distanca minimale në mes të objekteve individuale për banim duhet të jetë 5.00-10.00 m`;
- Distanca në mes të vijës ndërtimore dhe asaj rregulluese duhet të jetë 3.00÷5.00 m`;
- Për shtëpitë individuale të banimit, duhet të sigurohet 1 vendparkim, për një njësi banimi;
- Në kuadër të parcelës të parashihet hapësira për vendosjen e mbeturinave;
- Arkitektura/dukja e jashtme (fasada) e ndërtesave dhe materializimi i tyre, të jetë me materiale bashkëkohore dhe me masa të efijencës së energjisë, dhe ti përshtatet destinimit të ndërtesave të planifikuara;
- Zgjidhja e kulmit duhet të projektohet dhe të ekzekutohet ashtu që të jetë në harmoni me projektin arkitektonik dhe uji i strehëve duhet të derdhet brenda parcelës ndërtimore;

V.Kyçja në infrastrukturë - marrja e pëlqimeve nga KEDS-i dhe KUR “Prishtina”, bëhet me aplikim nga kjo drejtori. Për aplikim nevojitet prezantimi i dokumentacionit, me përcaktim të vendeve për kyçje në rrjetet përkatëse, dorëzuar veçantë në CD, me përmbajtje si në vijim:

- Emri (prindi) mbiemri i aplikuesit dhe numri i identifikimit dhe adresa;
- Informatën mbi lokacionin-adresa e saktë e hapësirës ndërtuese;
- Kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale;
- Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe pamjen në ortofoto të lokacionit me hapësirën ndërtuese;
- Përshkrimin teknik të objektit (destinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për elektrike dhe ujë).

Kyçja në infrastrukturë për ngrohje qendrore të bëhet në rrjetin ekzistues, pas sigurimit paraprak të kushteve detale dhe pëlqimit për kyçje nga “Termokos”-Ngrohitorja e Qytetit sh.a. dhe PTK.

VI.Para aplikimit për leje ndërtimore, duhet:

- Para aplikimit për leje ndërtimi të aplikoj për leje rrënimi për e ndërtuar në kuadër të parcelës;

VII. Dokumentacioni ndërtimor - projekti ideor, të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse për secilën fazë të projektit, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën IV., projekt propozimin e prezantuar, normave teknike për siguri nga zjarri si dhe normave dhe standardeve tjera për projektim të kësaj kategorie të ndërtesave, të dorëzohet në tre (3) kopje të shtypura, dhe një (1) digjitale dhe të përmbajë:

- Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës;
- Planin e situacionit të gjerë, në diametër prej 50m`, me ndërtesat ekzistuese dhe të planifikuara, në përpjesë 1:500 apo 1:1000, punuar në bazë të incizimit gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrethinë, si dhe me pozicionim të ndërtesës së projektuar dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01;
- Planin e situacionit të parcelës, në përpjesë 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë dhe me pozicionim të ndërtesës në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të platove, trotuareve, rrugëve dhe hyrjeve në përdhësë, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;

- Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:100, për ndërtesën e projektuar, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese dhe etazheve tjera, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Dukja e jashtme e ndërtimit, tridimensionale - perspektivë;
- Planin me vendin e qasjes në ujësjellës dhe kanalizim, në përpjesë 1:100;
- Planin me vendin e qasjes në furnizim me energji elektrike në përpjesë 1:100;
- Përshkrimin teknik të punëve ndërtimore;
- Paramasën dhe parallogarinë e punëve ndërtimore dhe ndërtimore zejtare;
- Detajet karakteristike dhe të nevojshme, në përpjesë 1:5, 1:10 apo 1:20;
- Situacionin me përshkrimin teknik të "Organizmi dhe masat e sigurisë në vend ndërtim";
- Masat propozuese për fizikën ndërtimore dhe atë të mbrojtjes nga zhurma, me analiza dhe masa konkrete;
- Deklaratën e projektuesit për fazat e nevojshme;

VIII. Marrëveshja për infrastrukturë – bazuar në nenin 23 të Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim dhe në nenin 10 dhe 11 të “Rregullore mbi Taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës” 01 nr. 434/01–0094474/17 dt. 24.04.2017, obligohet Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave e Komunës së Prishtinës, të vlerësojë një ngarkesë për të rimbursuar koston për krijimin, përmirësimin, zgjerimin apo riparimin e infrastrukturës, dhe të arrijë marrëveshje për infrastrukturë me pronarin/investitorin. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet, nga kjo drejtori, në kompetencë të Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave të Komunës së Prishtinës, për arritjen e kësaj marrëveshjeje. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/çertifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Vendimi për caktimin e kushtet ndërtimore, së bashku me situacionin e miratuar, të lëshuar nga kjo drejtori;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit të kompanisë investuese;
- Kontratën për bashkëinvestim (nëse është prezantuar në kërkesën për leje ndërtimore);
- Autorizimin për përfaqësim (nëse është prezantuar në kërkesën e lejes ndërtimore);
- Kopjen e letërnjoftimit të kërkuarit/ve (bashkëpronarëve të parcelës-ave dhe investitorit);

IX. Pagesa e taksës administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës, do të realizohet sipas “Rregullore mbi Taksën Administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës” 01Nr.434/01 – 0094474/17 dt.24.04.2017 dhe bazuar në dokumentacionin ndërtimor / projektin kryesor, si pjesë përbërëse e kërkesës për leje ndërtimore. Pagesa e taksës dhe tarifës, sipas këtij paragrafi, do të realizohet sipas afatit kohor të përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 16 të UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017, pas marrjes së konfirmimit për pagesë.

Pagesa e taksës administrative do të llogaritet edhe për rrënimin e ndërtimeve ekzistuese, në kuadër të parcelave kadastrale, bazuar në gjendjen ekzistuese, incizimin gjeodezik dhe projektin ideor të atyre ndërtimeve, sipas pikës 5.9 të nenit 5 të rregullores së lartcekur dhe vendimit për lejimin e rrënitimit.

X. Vlefshmëria e vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore do të jetë një (1) vit, me mundësi të vazhdimit për një (1) vit tjetër, në rastet kur nuk ka ndërruar gjendja ekzistuese apo dokumenti i planifikimit hapësinor, dhe me aplikim para skadimit të afatit të vlefshmërisë.

Pronari Florim Murtezi nga fsh.Hajvali-Prishtinë, me kërkesën 05 nr.350/02-112159/19 dt.16.05.2019, ka kërkuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit ideor, për ndërtimin e shtëpisë individuale të banimit, në lokacionin e përshkruar në paragrafin I. të dispozitivit të vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore.

Me kërkesë, pronari ka prezantuar dokumentacionin, si në vijim:

- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale nr.608-25, ZK Hajvali, evidentuar në certifikatën e njësisë kadastrale, P-71914002-00608-25, ZK Hajvali;
- Inçizimin gjeodezik të punuar nga kompania e licencuar “CADCOM”sh.p.k-Agon Blakaj -Bsc. Geo (kopje dhe në formë elektornike);
- Projektin konceptual për parcelën kadastrale në fjalë, të hartuar nga ”Infra-Ing‘’sh.p.k. nga Prishtina, me certifikatë të regjistrimit të biznesit nr.71008657;
- “Deklaratë nën betim” e përpiluar te noteri Kolë T Ramaj me LRP.Nr.1894/2017 me datë 21.09.2017, sipas të cilit Fadil Murtezi në cilësinë e pronarit të parcelës kadastrale nr. 608-23, Zk Hajvali, nën përgjegjësi të plotë morale, materiale dhe penale jep pëlqimin e plotë dhe të parevokushëm që Florim Murtezi të ndërtoj objektin ndërtimor në afërsi të pikës kufizuese(“mexhes”) të pronës së tij, nga ana Juglindje te ofrohet në distancë prej 2 metra (dy metra) ndërsa nga ana Veri-lindore të ofrohet në distancë prej 2.00 metra (dy metra) nga pika kufizuese (“mexha”) në mes njësisë së tij, me evidencë P-71914002-00608-25 ZK Hajvali, Komuna Prishtinë (kopje e vërtetuar me LRP. Nr.1211/2019 dt.20.06.2019);
- “Deklaratë nën betim” e përpiluar te noteri Kolë T.Ramaj me LRP.nr.1557/2017 me datë 14.08.2017, sipas të cilës Fadil Murtezi pronar i parcelës nr.608-23 dhe Florim Murtezi pronar i parcelës nr.608-25, me vullnet te plote dhe me përgjegjësi te plote morale, materiale dhe penale deklarojnë se janë të pajtimit të plotë që bashkarisht ta ndërtojnë, ta mirëmbajnë, ta shfrytëzojnë dhe që të dy të kenë qasje të barabartë në rrugën e cila rrugë lidhë të dy njësitë kadastrale të cilat gjinden në Zk Hajvali;
- Vërtetimin mbi obligimet tatimore, në emër të Florim Murtezi, nr.112129/19 dt.16.05.2019, lëshuar nga Drejtoria e Financave;
- Fotokopjen e dokumentit të identifikimit-letërnjoftimit të pronarit Florim Murtezi;
- Fotot e lokacionit.

Drejtoria e Urbanizmit, pas shqyrtimit të kërkesës 05 nr. 350/02-112159/19 dt.16.05.2019, dokumentacionit të prezantuar me prova të bashkangjitura, konsultimit të dokumenteve të planifikimit për hapësirën ku gjendet lokacioni, rregullativën ligjore në fuqi nga lëmi i planifikimit, ndërtimit dhe i procedurës së përgjithshme administrative, projektit konceptual, incizimit gjeodezik, ka konstatuar se ndërtesa e planifikuar për ndërtim sipas propozimit për Kushte Ndërtimore, e ka filluar ndërtimin, si dhe me punime ka arritur të bëjë betonimin e shtyllave të përdhësës, ku sipas inçizimit gjeodezik me koordinata nga gjeodeti i licencuar, ndërtesa e planifikuar është pozicionuar në distancën sipas situacionit të ngushtë (2.32 m) nga kufiri i parcelës kadastrale nr.608-23, pas sigurimit të pëlqimit / deklaratës të pronarit Fadil Murtezi të parcelës kadastrale nr.608-23 se, citojmë “Jap pëlqim të plotë dhe të parevokushëm që z.Florim Murtezi, të ndërtoj Objektin ndërtimor në afërsi të pikës kufizuese (“mexhës”) të pronës time, nga ana Juglindje të ofrohet në distancë prej 2 metra (dy metra) ndërsa nga ana Veri-lindore të ofrohet në distancëprej 2.0 metra(dy metra),nga pika kufizuese (“Mexha”)në mes të njësisë time dhe njësisë së tij, me evidencë P-71914002-00608-25, Z.K.Hajvali, Komuna Prishtinë”,i përpiluar te noteri Kolë Ramaj,LRP nr.1894/2017 dt.21.09.2017 (kopje e vërtetuar me LRP.nr.1211/2019 dt.20.06.2019) dhe pëlqimin për qasje në rrugë të përbashkët nga Fadil Murtezi Pronari i parcelës nr.608-23 Zona Kadastrale Hajvali , i përpiluar te noteri Kolë Ramaj, LRP nr.rendor.1557/2017.

Kjo Drejtori, bazuar në nenin 13, pika 1.2 të UA të MMPH-së Nr. 06/2017 dt.23.05.2017, ka vendosur njoftimin me datë 06.06.2019. Ky njoftim publik, sipas rregullativës ligjore, ka qëndruar pesë (5) ditë në lokacionin në fjalë dhe meqë ndërkohë kjo drejtori nuk ka pranuar ndonjë vërejtje apo sygjërim, është vazhduar me procedurën për caktimin e kushteve ndërtimore.

Sipas mendimit profesional nga faza e komunikacionit, të dt. 03.07.2019, lidhur me rrugën për kyçje të automjeteve në rrugën ekzistuese për shtëpinë individuale e banimit B+P+1, mund të pranohet si i tillë. Kyçja duhet ti përshtatet teknikisht rrugës ekzistuese dhe të aplikohen kushtet e shikueshmërisë horizontale dhe vertikale në lokacionin e kyçjes edhe në kohën kur realizohet ajo.

Bazuar në konstatimet e më sipërme, rregullativën ligjore në fuqi, konkretisht nenin 18 të Ligjit për Ndërtim Nr. 04/L- 110 dt. 31.05.2012, nenin 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 31.07.2013, nenin 7 dhe 8 të UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrërimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve”, Drejtoria e Urbanizmit ka konstatuar se kërkuessit kanë prezantuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, dhe se projekti konceptual i prezantuar, është në harmoni me destinimin dhe kriteret tjera të Planit Zhvillimor Komunal-PZHK-ë/ për atë hapësirë, si dhe në harmoni me rrethinën, andaj konstatohet se janë plotësuar të gjitha kriteret e parapara ligjore për caktimin e këtyre kushteve ndërtimore.

Nga sa u cek më lartë, u vendos si në dispozitiv të vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore.

Shtojcë: Situacioni i ngushtë me zgjidhje urbane.

Udhëzim juridik: Pala e pakënaqur me këtë vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPH-ja.

Ky Akt përcjellës u përpilua në 4 (katër) kopje identike dhe i dërgohet: Kërkuessit, Qendrës për shërbim me qytetarë, kësaj drejtorie dhe në dosje të lëndës.

Kopja elektronike e këtij Vendimi i dërgohet: Drejtorisë së Planifikim Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm.


**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 350/02-112159/19 DT. 03.07.2019**

Zyrtari,
Leonora Mehmeti



u.d.Udhëheqëse e Sektorit
Mimoza Berisha Prestreshi





62
φ658.08
1235-10

60
φ658.00

58
φ657.75

59
φ657.45

57
φ657.14

16
φ657.16

56
φ657.14

15
φ657.54

14
φ656.92

13
φ656.81

12
φ656.70

18
φ656.73

608-32

0608-32

608-33

22
φ656.15

21
φ656.15

20
φ656.58

19
φ656.58

18
φ656.58

17
φ656.58

16
φ656.58

15
φ656.58

14
φ656.58

13
φ656.58

0611-0

0612-1

43
φ656.61

44
φ656.47

33
φ656.47

32
φ656.47

31
φ656.47

30
φ656.47

29
φ656.47

28
φ656.47

27
φ656.47

26
φ656.47

25
φ656.47

24
φ656.47

23
φ656.47

22
φ656.47

21
φ656.47

20
φ656.47

19
φ656.47

18
φ656.47

17
φ656.47

16
φ656.47

15
φ656.47



14
φ656.47

13
φ656.47

12
φ656.47

11
φ656.47

10
φ656.47



SIPARFABELET BRUTO

SIP. SUTERENIT - 32.42M²
SIP. PËRDHESIS - 123.26M²
SIP. NETO - 128.53M²

SIP. TOTALE BRUTO E NDËRTIMIT - 284.21M²

SIP. PËRDHESIS - 123.26M²
SIP. NGASTRËS - 588.00M²

SIP. E NDËRTUAR - 20.96%
SIP. E GJELBRUAR - 79.04%

Infra-Ing
design & construction

Adresa: Kofë Bardha No. 27, Durrës - Shqipëri.
E-mail: infraing.sq@gmail.com
Tel: +37744 990318 - +37744 480013 - +37744 200 900

PROJEKTOI:
I. d. a. HEBIB YMERI

PERPUNIMTARËNK:
ERIK LINDONER BEHRAMJI

PERMATEJA E VIZATIMIT:
SHTËPIE BANIMI S.P-P-1-HAJVALI

DATA:	NËNTOR 2017
FAZA:	A R K I T E K T U R A
INVESTORI / KLIENI:	Floimë (brëmbim) MURTEZI
OBJEKTI, BAZHIERI, VENI I NDËRTIMIT:	SHTËPIE BANIMI S-P-P-1-HAJVALI
PERMATEJA E VIZATIMIT:	PERMATEJA E VIZATIMIT
SHALLI / NIVELI:	1:200
NUMRI I DOKUMENTIT:	DIKJ / NIFA / A3
NUMRI I NGJESHËS:	NR.02

- LEGJENDA
- VIA KADASTRALE
 - VIA NDËRTIMORE
 - KUFIRI I PARCELLËS
 - MURI I BETONIT
 - RRUGË E PASHTRUAR
 - HAPSIRA GJELBRUSE
 - SHPH-HNK
 - OBJEKTI I PËRKOHSHËM
 - SHTËPIT EGZISTUSE



